

VENDIM
Nr.338, datë 26.8.1997

PËR HARTIMIN E RREGULLORES SË RE TË KUVENDIT POPULLOR

Në mbështetje të nenit 18, paragrafi i dytë i ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Të hartohet rregullorja e re e Kuvendit Popullor.
2. Ngarkohet Komisioni i përhershëm e Kuvendit Popullor i Mandateve, Imunitetit dhe Rregullore të përgatisë projektin e kësaj rregulloreje. Në këtë komision të marrë pjesë edhe një përfaqësues i çdo grupi parlamentar që nuk ka anëtar në këtë komision.
3. Projekti përfundimtar i rregullore t'i paraqitet Kryesisë së Kuvendit Popullor.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i saj të bëhet para datës 31 tetor 1997.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë